



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 07, Datë 06.01.2025

MBI

**ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT LIDHUR ME KËRKESËN E
SHOQËRISË “MER ENERGJI” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 ë ligjit nr. 43/2015 *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, i ndryshuar; nenit 14, pika 3 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.01.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2410 prot., datë 27.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve *“Mbi kërkesën e shoqërisë “MER ENERGJI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”*,

Konstatoi se:

- Shoqëria “MER ENERGJI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2410 prot., datë 18.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Faqekuq 3”, me kapacitet të instaluar 1300 kW, me vendndodhje në Fshatin Vlush, Njësia Administrative Leshnje, Bashkia Skrapar, Qarku Berat.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 258, datë 02.12.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “MER ENERGJI” sh.p.k. për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 03.12.2024 dhe 04.12.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 12.12.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Gjithashtu, me shkresën nr. 2426/4 prot, datë 05.12.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, duke i kërkuar gjithashtu që të shprehet nëse ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratës së paraqitur në kuadër të këtij aplikimi dhe të drejtën e shoqërisë “MER ENERGJI” sh.p.k. për ndërtimin

dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Deri në këtë vendimmarrje, nga MIE nuk ka pasur asnjë përgjigje.

- Me shkresën nr. 2426/3 prot., datë 05.12.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka kërkuar plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar.
- Shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues me shkresën nr. 2426/5 prot., datë 24.12.2024.
- Në nenin 14, pika 3, parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*
- Për sa më lart, me qëllim shqyrtimin e dokumentacionit plotësues të depozituar nga shoqëria dhe/ose zhvillimin e një korrespondence të mundshme në vijim, vlerësojmë të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “MER ENERGJI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “MER ENERGJI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “MER ENERGJI” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI